

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON PRIVATIZATION AGENCY OF KOSOVO RELATED MATTERS	POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA O PITANJIMA KOJA SE ODMOSE NA KOSOVSKU AGENCIJU ZA PRIVATIZACIJU
--	---	---

SCEL – 10 - 0029

**Punëtorët e NSH**

*Ankuesit*

1. S.S., fshati XX, XX
  2. H.D., XX, XX
  3. R.R., fshati XX, XX
  4. B.M., fshati XX, XX
  5. R.O., fshati XX, XX
  6. M.S., fshati XX, XX
  7. R.D., fshati XX, XX
  8. M.T., XX, XX
  9. D.P., XX, XX
  10. R.S., XX, XX
  11. P.Z., XX, XX
  12. D.C., XX, XX
  13. R.G., fshati XX, XX
  14. D.B., fshati XX, XX
  15. M.Z., XX, XX
- Përfaqësuar nga avokati
16. Z.J., XX, XX
  17. M.K. përfaqësuar nga avokati
  18. Z.K. Përfaqësuar nga avokati
  19. V.V., XX, XX

kundër

*E paditur*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**  
Ilir Konushevc nr.8, Prishtinë

Kolegji i parë i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit i përbërë nga kryetari i trupit gjykues Alfred Graf von Keyserlingk, gjyqtari Shkelzen Sylaj dhe gjyqtari Qerim Fazliji, pas shqyrtimit të mbajtur më 27 dhjetor 2012, lëshon këtë:

**AKTGJYKIM**

1. Ankesa e V.V. (C19) është e papranueshme.

2. Ankesat e S.S.(C1), H.D.(C2), R.O.(C5), M.S.(C6), R.D.(C7) janë të pranueshme, por të pabazuara.

3. Ankesat e R.R.(C3), B.M.(C4), M.T.(C8), D.P.(C9), R.S.(10), P.Z.(C11), D.C.(C12), R.G.(C13), D.B.(C14), M.Z.(C15), Z.J.(C16), M.K.(C17), Z.K. (C18) janë të pranueshme dhe të bazuara. Ata duhet të pranohen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime.

### Rrethanat faktike dhe procedurale

Ankuesit janë ish-punëtorë të NSH e cila është privatizuar përmes spin off-it të zakonshëm nga i padituri. Kontrata e shitjes me ofertuesin fitues ishte ratifikuar më 08 qershor 2006.

Lista e përkohshme e punonjësve të kualifikuar është publikuar më 16 maj 2009 dhe data e fundit për dorëzimin e ankesave në AKP kundër listës së përkohshme ishte 8 qershor 2009.

Lista përfundimtare është publikuar më 2 dhjetor 2010 dhe afati përfundimtar për paraqitjen e ankesave në Dhomën e Posaçme ishte me 25 dhjetor 2010.

Më 6 dhjetor 2010 S.S., (**ankuesi C1**) ka parashtruar ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej "AKP") duke kërkuar përfshirjen në listën e punonjësve me të drejta legjitime që të marrin pjesë në 20% të të ardhurave të privatizimit të ndërmarrjes shoqërore (SOE), siç janë publikuar me 2 dhjetor 2010. Ankuesi, data e lindjes 28 korrik 1946, ka punuar në NSH nga 15 prill 1966 deri më 30 dhjetor 1996, kur asaj iu ishte dashur ta lë punën për arsye shëndetësore. Ajo tregon se nuk është e drejtë që ajo është përjashtuar nga lista, sepse ajo ka punuar atje për më shumë se 30 vjet dhe NSH është e vetmja ndërmarrje ku ajo ka punuar. Ajo paraqet kopjen e kartës së identitetit, dhe certifikatën e martesës, certifikatën e punësimit.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 16 dhjetor 2010 AKP-ja ka theksuar se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme për shkak se ankuesi kishte dështuar të paraqesë ankesë në Agjenci kundër listës së përkohshme të punëtorëve. AKP-ja argumenton se ankuesi, pra nuk arriti të shterojë të gjitha

mjetet juridike administrative të ankimimit para se t'i drejtohej gjykatës siç kërkohet sipas nenit 127.4 të ligjit mbi procedurën administrative 02/L-28.

Më 10 dhjetor 2010 H.D., **(ankuesi C2)** kishte parashtruar ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP –së duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë një pjesë nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi ka punuar në NSH nga 01.06.1981 – 29.12.1981, 22.03.1982-30.11.1992, 01.12.1993-02.09.1993 dhe 01.07.1999-30.03.2003. Ankuesi u lind më 28 maj 1937 dhe kërkon nga Dhoma e Veçantë të mos e hedhë poshtë ankesën e tij në bazë të asaj se ai ka arritur moshën e daljes në pension. Ai parashtron kopjen e librezës së punës dhe kartën e identitetit.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 28 dhjetor 2010, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar, sepse ankuesi nuk i përmbush kërkesat ligjore për të qenë në listë. Ankuesi ka punuar në NSH deri në 30.03.2003 dhe për këtë arsye ai nuk ishte i regjistruar në NSH në kohën e privatizimit. Më tej, ankuesi kishte arritur moshën e daljes në pension në kohën e privatizimit.

Më 9 dhjetor 2010, R.R.**(ankuesi C3)** ka parashtruar ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë një pjesë nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së të publikuar në "Kosova Sot" më 2 dhjetor 2010. Ankuesi, data e lindjes 23 nëntor 1935, ka punuar nga 6 gushti 1990 deri më 29 maj 2009. Ai ishte punësuar si punëtor ndërtimi. Ai pohon se ka vazhduar të punojë edhe pas përfundimit të luftës dhe gjatë gjithë kohës deri në privatizimin e NSH-ve kështu që ai i plotëson të gjitha kërkesat ligjore. Ai parashtron kopjen e librezës së punës, kartën e identitetit, certifikatën e punësimit.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 24 dhjetor 2010, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme për shkak se ankuesi kishte dështuar të paraqesë ankesë pranë Agjencisë kundër listës së përkohshme të punëtorëve. AKP-ja argumenton se ankuesi, pra nuk arriti të shterojë të gjitha mjetet juridike administrative të ankimimit para se t'i drejtohej gjykatës siç kërkohet sipas nenit 127,4 të ligjit për procedurën administrative 02/L-28.

Më 14 dhjetor 2010 B.M. **(Ankuesi C4)** ka parashtruar ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë një pjesë nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së të publikuar në "Vjesti". Ankuesi ka punuar në NSH për 19 vjet, nga 7 prill 1980 deri më 25 mars 1999. Ai thekson se pas përfundimit të konfliktit ai ishte përpjekur të kthehej në punë dhe ishte regjistruar në listën e pritjes. Ai pohon se

ai ishte diskriminuar për shkak të kombësisë së tij. Ai parashtron kopjen e certifikatës së punësimit.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 28 dhjetor 2010, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë, sepse ankuesi nuk i përmbush kërkesat ligjore për të qenë në listë. Ankuesi kishte dështuar për të provuar se ai ishte i punësuar në NSH pas vitit 1999 dhe se ai ishte diskriminuar. Ankuesi nuk ishte regjistruar si i punësuar në kohën e privatizimit.

Më 14 dhjetor 2010 R.O.(**Ankuesi C5**) ka parashtruar ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë një pjesë nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së të publikuar në gazetën ditore më 2 dhjetor 2010. Ankuesi, data e lindjes 4 dhjetor 1935, ka punuar në NSH nga 1 prill 1976 deri më 3 prill 1996, kur ai kishte për të lënë punën për arsye shëndetësore.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 30 dhjetor 2010 AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme për shkak se ankuesi kishte dështuar të parashtroi ankesë pranë Agjencisë kundër listës së përkohshme të punëtorëve. AKP-ja argumenton se ankuesi, pra nuk arriti të shterojë të gjitha mjetet juridike administrative të ankimimit para gjykatës siç kërkohet sipas nenit 127,4 të ligjit për procedurën administrative 02/L-28..

Më 16 dhjetor 2010 M.S. (**ankuesi C6**) parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë një pjesë nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së të publikuar në gazetën e përditshme më 2 dhjetor 2010 është korrigjuar kështu që ajo tregon 15 vitet e tij të punësimit në NSH prej 6 vitesh siç ishte publikuar. Ankuesi, data e lindjes 6 mars 1944, ka punuar në NSH nga 6 maj 1991 deri më 28 prill 2006, kur atij i është dashur ta linte punën. Ai parashtron një kopje të certifikatës së punësimit dhe të listës së pagave.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 30 dhjetor 2010, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme për shkak se ankuesi kishte dështuar të parashtroi ankesë pranë Agjencisë kundër listës së përkohshme të punëtorëve. AKP-ja argumenton se ankuesi, pra nuk arriti të shterojë të gjitha mjetet juridike administrative të ankimimit pranë gjykatës siç kërkohet sipas nenit 127,4 të ligjit për procedurën administrative 02/L-28.

Më 17 dhjetor 2010 R.D., (**ankuesi C7**) parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë një pjesë nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së të

publikuar në gazetën ditore më 2 dhjetor 2010. Ankuesi, data e lindjes 18 mars 1939, ka punuar në NSH nga 23 maj 1984 deri më 30 nëntor 1999, kur atij i është dashur ta linte punën për arsye shëndetësore. Ai pohon se ishte përpjekur të kthehej në punë pas luftës. Ai parashtroi kopjen e librezës së punës.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 30 dhjetor 2010 AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme për shkak se ankuesi kishte dështuar të parashtroi ankesë pranë Agjencisë kundër listës së përkohshme të punëtorëve. AKP-ja argumenton se ankuesi, pra nuk arriti të shterojë të gjitha mjetet juridike administrative të ankimit pranë gjykatës siç kërkohet sipas nenit 127,4 të ligjit për procedurën administrative 02/L-28.

Më 22 dhjetor 2010 M.T. (**Ankuesi C8**) parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë një pjesë nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së të publikuar në "Blic" më 2 dhjetor 2010. Ankuesi ka punuar në NSH nga 22 mars 1982 deri në qershor të vitit 1999. Ankuesi thekson se ajo nuk mundi të shkonte në punë pas qershorit 1999, sepse asaj i ishte dashur të largohej nga Istogu për shkak të situatës së rrezikut për jetën. Ajo ankohet se ishte diskriminuar, sepse ajo është e përkatësisë etnike serbe. Ajo paraqet kopjen e librezës së punës dhe librezën e sigurimit shëndetësor.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 6 janar 2011 AKP argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë, sepse ankuesi nuk i përmbush kërkesat ligjore për të qenë në listë. AKP-ja thekson se ankuesi nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi se punësimi i saj në NSH kishte vazhduar pas qershorit të vitit 1999 dhe për të provuar pretendimet e saj se ajo ishte diskriminuar. AKP-ja pohon se ankuesi ka dështuar të ofrojë dëshmi se ajo kërkoi siguri nga KFOR-i apo Policia e UNMIK-ut pas vitit 1999.

Në përgjigjen e 30 korrikut 2012 ankuesja thekson se pas qershorit 1999 ajo nuk ishte në gjendje të vazhdojë të punoj në, sepse ajo sepse asaj i ishte dashur të largohej nga Istogu pasi kishte frikë për jetën e saj dhe jetën e anëtarëve të familjes së saj. Lidhur me diskriminimin ajo thotë se ishte fakt i njohur që pas qershorit 1999 situata në Kosovë ishte e tillë që liria e lëvizjes për jo-shqiptarët nuk ishte e mundur. Ankuesja thekson se gjatë kësaj kohe shtëpitë serbe u shkatërruan, plaçkitën, ishin vrarë e kidnapuar njerëz, nuk kishte asnjë praktikë të kërkimit të përcjelljes për të shkuar për të punuar në dhe nga ndërmarrjet në pronësi shoqërore, e as që ishte realiste. Ajo argumenton se në qoftë se vërejtjet (nga AKP-ja) ishin të bazuara, atëherë pse listat e punëtorëve po shpallehin në gazetën ditore të botuara në Serbi.

Më 22 dhjetor 2010 D.P. (**Ankuesi C9**) parashtroi ankesë në Dhomën e

Posaçme kundër AKP-së duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë një pjesë nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së të publikuar në "Blic" më 2 dhjetor 2010. Ankuesi ka punuar në NSH nga 21 prill 1985 deri në qershor të vitit 1999. Ankuesi thekson se ai nuk mundi të shkojë në punë pas qershorit 1999, sepse atij i ishte dashur të largohej nga Istogu për shkak të situatës së rrezikshme për jetën. Ai ankohet ai ishte diskriminuar për shkak se është i përkatësisë etnike serbe, paraqet kopjen e librezës së punës.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 6 janar 2011 AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme për shkak se ankuesi kishte dështuar të parashtroi ankesë pranë Agjencinë kundër listës së përkohshme të punëtorëve. AKP-ja argumenton se ankuesi, pra nuk arriti të shterojë të gjitha mjetet juridike administrative të ankimit para gjykatës siç kërkohet sipas nenit 127,4 të ligjit për procedurën administrative 02/L-28.

Më 22 dhjetor 2010 R.S. (**Ankuesi C10**) parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë një pjesë nga të ardhurat e privatizimit të NSH të publikuar në "Blic" më 2 dhjetor 2010. Ankuesi ka punuar në NSH nga 2 korrik 1984 deri në qershor të vitit 1999. Ankuesi thekson se ai nuk mundi të shkonte në punë pas qershorit 1999, sepse atij i ishte dashur të largohej nga Istogu për shkak të situatës së rrezikut për jetën. Ai ankohet se ishte diskriminuar për shkak se është i përkatësisë etnike serbe. Ai paraqet kopjen e librezës së punës.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 6 janar 2011 AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme për shkak se ankuesi kishte dështuar të parashtroi ankesë pranë Agjencisë kundër listës së përkohshme të punëtorëve. AKP-ja argumenton se ankuesi, pra nuk arriti të shterojë të gjitha mjetet juridike administrative të ankimit pranë gjykatës siç kërkohet sipas nenit 127, 4 të ligjit për procedurën administrative 02/L-28.

Më 22 dhjetor 2010 P.Z. (**ankuesi C11**) parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë një pjesë nga të ardhurat e privatizimit të NSH të publikuar në "Blic" më 1 dhjetor 2010. Ankuesi ka punuar në NSH nga 23 nëntor 1983 deri në qershor të vitit 1999. Ankuesi thekson se ai nuk mundi të shkonte në punë pas qershorit 1999, sepse atij i ishte dashur të largohej nga Istogu për shkak të situatës së rrezikshme për jetën. Ai ankohet se ishte diskriminuar për shkak se është i përkatësisë etnike serbe. Ai paraqet kopjen e librezës së punës.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 6 janar 2011 AKP-ja argumenton

se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme për shkak se ankuesi kishte dështuar të paraqesë ankesë pranë Agjencisë kundër listës së përkohshme të punëtorëve. AKP argumenton se ankuesi, pra nuk arriti të shterojë të gjitha mjetet juridike administrative të ankimimit para gjykatës siç kërkohet sipas nenit 127,4 të ligjit për procedurën administrative 02/L-28.

Më 22 dhjetor 2010, D.C. **(Ankuesi C12)** parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë një pjesë nga të ardhurat e privatizimit të NSH të publikuar në "Blic" më 1 dhjetor 2010. Ankuesi ka punuar në NSH nga 2 prill 1991 deri në qershor të vitit 1999. Ankuesi thekson se ai nuk mundi të shkonte në punë pas qershorit 1999, sepse atij i ishte dashur të largohej nga Istogu për shkak të situatës së rrezikshme për jetën. Ai ankohet se ishte diskriminuar për shkak se është i përkatësisë etnike serbe. Ai paraqet kopjen e librezës së punës.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 6 janar 2011, AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme për shkak se ankuesi kishte dështuar të paraqesë pranë Agjencisë kundër listës së përkohshme të punëtorëve. AKP argumenton se ankuesi, pra nuk arriti të shterojë të gjitha mjetet juridike administrative të ankimimit para gjykatës siç kërkohet sipas nenit 127.4 të ligjit për procedurën administrative 02/L-28.

Më 22 dhjetor 2010, R.G. **(Ankuesi C13)** parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë një pjesë nga të ardhurat e privatizimit të NSH të publikuar në gazetën më 2 dhjetor 2010. Ankuesi, data e lindjes 25 shtator 1941, ka punuar në NSH nga 2 gusht 1988 deri më 27 mars 1999, kur ai u detyrua të largohet nga Kosova. Ankuesi u kthye në Kosovë pas konfliktit. Ai pohon se ishte përpjekur të kthehej në punë, megjithatë, menaxhmenti nuk e kishte marrë atë përsëri, por i ishte premtuar se do të kontaktohej nëse do të kishte punë për të. Ai paraqet kopjen e librezës së punës.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 24 janar 2011 AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme për shkak se ankuesi kishte dështuar të paraqesë ankesë pranë Agjencisë kundër listës së përkohshme të punëtorëve. AKP-ja argumenton se ankuesi, pra nuk arriti të shterojë të gjitha mjetet juridike administrative të ankimimit para gjykatës siç kërkohet sipas nenit 127, 4 të ligjit për procedurën administrative 02/L-28.

Më 23 dhjetor 2010 D.B. **(Ankuesi C14)** parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë një pjesë nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi, data e lindjes 6 korrik 1958, ka punuar në NSH nga 1 prill 1981 deri

më 14 qershor 1999, kur u detyrua të largohet nga Kosova. Ankuesi u kthye në Kosovë pas konfliktit. Ai pohon se ishte përpjekur të kthehej në punë, megjithatë, menaxhmenti nuk e kishte marrë atë përsëri, por i ishte premtuar se do të kontaktohej nëse do të kishte punë për të. Ai parashtron në punësim broshurë kopje.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 24 janar 2011 AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme për shkak se ankuesi kishte dështuar të parashtroi ankesë pranë Agjencisë kundër listës së përkohshme të punëtorëve. AKP argumenton se ankuesi, pra nuk arriti të shterojë të gjitha mjetet juridike administrative të ankimit para gjykatës siç kërkohet sipas nenit 127, 4 të ligjit për procedurën administrative 02/L-28.

Më 24 dhjetor 2010 M.Z. (**Ankuesi C15**) parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë një pjesë nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi ishte i punësuar në NSH deri në qershor 1999, kur atij i ishte dashur të largohej nga Istogu për shkak të situatës së rrezikshme për jetën. Ai ankohet se ishte diskriminuar për shkak se është i përkatësisë jo shqiptare. Ankuesi paraqet vendimet e NSH-ve në lidhje me pushimin vjetor dhe kopjen e ID-së.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 24 janar 2011 AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme për shkak se ankuesi kishte dështuar të parashtroi ankesë pranë Agjencisë kundër listës së përkohshme të punëtorëve. AKP-ja argumenton se ankuesi, pra nuk arriti të shterojë të gjitha mjetet juridike administrative të ankimit pranë gjykatës siç kërkohet sipas nenit 127, 4 të ligjit për procedurën administrative 02/L-28.

Më 24 dhjetor 2010 Z.J. (**Ankuesi C16**) parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë një pjesë nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi ka punuar në NSH nga 25 qershor i 1985 deri më 14 qershor 1999, kur atij i ishte dashur të largohej nga Istogu për shkak të situatës së rrezikshme për jetën si të gjithë të punësuarit tjerë serbë. Ai pohon se ai plotëson kërkesat ligjore të jetë në listë dhe për këtë arsye ai ishte diskriminuar. Ankuesi thekson se ai është në të njëjtën situatë si të tjerët në listë, në veçanti nga 11 punëtorët të etnicitetit serb që janë larguar nga Kosova bashkë me të dhe janë persona të zhvendosur qysh prej atëherë dhe janë të papunë. Ai dëshiron që të njëjtat kriteret të zbatohen poashtu edhe tak ai. Ai paraqet një kopje të vërtetuar të librezës së punës.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 24 janar 2011 AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme për shkak se ankuesi kishte



dështuar të parashtronte ankesë pranë Agjencisë kundër listës së përkohshme të punëtorëve. AKP argumenton se ankuesi, pra nuk arriti të shterojë të gjitha mjetet juridike administrative të ankimimit pranë gjykatës trajtimin siç kërkohet sipas nenit 127, 4 të ligjit për procedurën administrative 02/L-28.

Më 24 dhjetor 2010 M.K. (**ankuesi C17**) parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë një pjesë nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi më herët kishte kundërshtuar vendimin e AKP-së në lidhje me listën e përkohshme të publikuar nga AKP-ja. Ankesa u hodh poshtë nga AKP-ja. Ankuesi ishte i punësuar në NSH nga 5 marsi 1978 deri në qershor 1999, kur ai u detyrua të largohet nga Kosova dhe u vendosë në Mal të Zi. Gjithë pasuria e tij në Kosovë u shkatërrua dhe u dogj. Ankuesi thekson se ai i plotëson të gjitha kërkesat dhe se ai ishte diskriminuar. Ai paraqet një kopje të librezës së punës.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 24 janar 2011 AKP argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme, sepse ankuesi nuk kishte arritur të parashtroi ankesë pranë Agjencinë kundër listës së përkohshme të punëtorëve. AKP argumenton se ankuesi, pra nuk arriti të shterojë të gjitha mjetet juridike administrative të ankimimit para gjykatës siç kërkohet sipas nenit 127, 4 të ligjit për procedurën administrative 02/L-28.

Më 24 dhjetor 2010 Z.K. (**Ankuesi C18**) parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë një pjesë nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi më herët kishte kundërshtuar vendimin e AKP-së në lidhje me listën e përkohshme të publikuar nga AKP-ja. Ankesa u hodh poshtë nga AKP-ja. Ankuesi ishte i punësuar në NSH nga 4 janar 1977 deri në qershor 1999, kur u detyrua të largohet nga Kosova dhe u vendos në Malin e Zi. E gjithë prona e saj në Kosovë u shkatërrua dhe u dogj. Ankuesi thekson se ajo i plotëson të gjitha kërkesat dhe se ajo ishte diskriminuar. Ankuesi paraqet një kopje të librezës së punës.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 24 janarit 2011 AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme për shkak se ankuesi kishte dështuar të parashtroi ankesë pranë Agjencisë kundër listës së përkohshme të punëtorëve. AKP-ja argumenton se ankuesi, pra nuk arriti të shterojë të gjitha mjetet juridike administrative të ankimimit pranë gjykatës trajtimin siç kërkohet siç kërkohet sipas nenit 127, 4 të ligjit për procedurën administrative 02/L-28

Më 7 prill 2011 ankesa e V.V. (**ankuesi C19**) është regjistruar në Dhomën e

Posaçme siç është referuar nga AKP-ja duke pasur të bashkangjitur: kopjen e librezës së punës dhe pasaportën.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 15 shtator 2011 AKP-ja argumenton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme për shkak se afati i fundit për paraqitjen e ankesave në Dhomën e Veçantë ishte më 25 dhjetor 2010.

Lidhur me tej detajet e mëtutjeshme, referenca është bërë në dosjen e gjykatës.

### Arsyetimi ligjor

1.

Ankesa e V.V. (C19) është e papranueshme.

Sipas nenit 10.6 (a) të rregullores së UNMIK-ut 2003/13 ankesa kundër Listës Përfundimtare duhet të dorëzohet në Dhomën e Posaçme brenda 20 ditëve pas shpalljes së listës përfundimtare. Publikimi i listës përfundimtare ishte bërë më 2 dhjetor 2010 me afat ligjor 25 dhjetor 2010. Ankesa së pari ishte dërguar nga ankuesi të i padituri dhe ishte marrë nga i padituri më 11.01.2011, pastaj është përcjellur nga i padituri në gjykatë dhe është marrë nga gjykata më 07.04.2011. Të dyja datat janë jashtë afatit ligjor 25.12.2011. Prandaj kjo ankesë është e papranueshme.

2.

Të gjithë ankesa tjera (C1-C18) janë parashtruar para afatit të 25 dhjetorit 2012. Ato të gjitha janë të pranueshme.

Moskundërshtimi i ankuesve ndaj listës së përkohshme sipas nenit 67.2 të urdhëresës administrative të UNMIK-ut 2008/6 nuk e bën të papranueshme padinë kundër listës përfundimtare.

a. Neni 127 i ligjit për procedurën administrative nr. 02/L-28 nuk aplikohet. Neni 127 thotë:

#### *Ankimi administrativ*

*127.1. Ankimi administrativ mund të bëhet në formë të kërkesës për rishqyrtim ose të ankesës.*

*127.2. Çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet kundër një akti administrativ ose kundër refuzimit të paligjshëm për nxjerrjen e aktit administrativ.*

*127.3. Organi administrativ të cilit i drejtohet ankimi shqyrton ligjshmërinë dhe rregullsinë e aktit të kontestuar.*

*127.4. Palët e interesuara mund t'i drejtohen gjykatës vetëm pasi të kenë shteruar mjetet administrative të ankimit.*

Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2008/6 në nenin 70.3 (a) dhe (b) në bazë të titullit të ligjit në fuqi nuk i referohet Ligjit për Procedurën Administrative nr. 02/L-28, por i referohet Kodit të Procedurës Kontestimore i cili nuk përmban asnjë dispozitë që kërkon shterimin e të gjitha mjeteve juridike administrative para paraqitjes në gjykatë.

Por edhe nëse neni 127 i ligjit për procedurën administrative nr. 02/L-28 do të zbatohet, ankuesit nuk do të kishin nevojë për të kundërshtuar listën e përkohshme para ankimit kundër listës përfundimtare. Padia e tyre nuk ka të bëjë me listën e përkohshme (që mund të ketë qenë kundërshtuar), por listën përfundimtare (kundër të cilës nuk është i mundur asnjë mjet administrativ).

b. Gjithashtu formulimi i nenit 67.2, fjalia e parë, urdhëresa administrative e UNMIK-ut 2008/6 nuk mund të interpretohet në atë mënyrë që i punësuarit duhet të sfidojë listën e përkohshme në mënyrë që të ketë të drejtë të ankohet më vonë kundër listës përfundimtare. Neni 67.2, fjalia e parë, urdhëresa administrative e UNMIK-ut 2008/6 thotë:

*67.2 Pas pranimit të listës së punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit publikon një listë të përkohshme të punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën bashkë me një njoftim për publikun mbi të drejtën e çdo personi që brenda 20 ditësh të parashtrijë ankesë në këtë agjenci për përfshirje në listë ose kundërshtimin e listës së punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën.*

Ligji vetëm thekson të drejtën për të kundërshtuar, jo si një detyrim.

c. Kolegji është në dijeni se një detyrim për të sfiduar ndonjë mangësi në listën e përkohshme të kombinuara me sanksion, se në qoftë se kjo nuk është bërë ankesa kundër listës përfundimtare bëhet e papranueshme do të ndihmojë Agjencinë për krijimin në kohë të shkurtër të një listë të korigjuar përfundimtare.

Obligimi që të shterohen mjetet juridike administrative para adresimit në gjykatë do të ndalonte palën nga përdorimi i burimeve të gjyqësorit, pa nevojë.

Procedura të ketë themeluar së pari një listë të përkohshme dhe për t'u dhënë mundësinë të gjithëve për të kundërshtuar këtë listë dhe të paraqesë fakte dhe prova brenda 20 ditëve do të ndihmojë AKP për të krijuar pa vonesë të panevojshme një listë të korigjuar përfundimtare. Ajo ka për qëllim të

përqendrojë dhe të përshpejtojë procedurën. Mbledhja e të gjitha fakteve dhe provave të nevojshme, sa më herët që të jetë e mundur është një aset i rëndësishme në një kontekst procedural në të cilin shuma monetare e 20% të çdo punonjësi është në varësi të vendimit për praninë ose refuzim.

Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2008/6 nuk lejon sanksionimin e mungesës së bashkëpunimit të Punësuarit në fazën e krijimit të listës përfundimtare duke bërë ankesë kundër listës përfundimtare të papranueshme (e ngjashme: Aktgjykimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme SCEL-09-0001).

3. Ankesat e S.S.(C1), H.D.(C2), R.O.(C5), M.S.(C6), R.D.(C7) janë të pranueshme, por të pabazuara.

Neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, të ndryshuar me Rregulloren 2004/45, siguron kushtet për një punonjës të konsiderohen të pranueshme dhe Neni 10 përcakton procedurën për parashtrimin e një ankese në Dhomën e Posaçme, siç vijon:

*"10.4 Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit apo të fillimit të procedurës së likuidimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri vite. Kjo kërkesë nuk i përjashton punëtorët nga paraqitja e ankesës në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6., të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar po të mos kishin qenë të diskriminuar. "*

Ankesat e S.S.(C1), H.D.(C2), R.O.(C5), M.S.(C6), R.D.(C7) me 08.03.2006, kur u privatizua NSH nga shitja me ofertuesin më të lartë as nuk ishin të regjistruar si punonjës të NSH-së, dhe as nuk ishin në listën e pagave. Kjo nuk ishte për shkak të ndonjë diskriminimi, por në rastin e H.D.(C2), i cili ka lindur në vitin 1937 për faktin se ai ishte në pension dhe tashmë në rastet e S.S.(C1), R.O.(C5) dhe R.D.(C7) në faktin se të tre më herët e kishin lënë punën me NSH për arsye shëndetësore. Gjithashtu M.S.(C6) nuk pretendon se i është dashur ta lë punën për shkaqe të diskriminimit, por vetëm ka deklaruar se "për shkak të rrethanave të caktuara" ka dalë në pension.

Rregullorja e UNMIK-ut 2003/13 përjashton nga 20% të gjithë ata që në kohën e privatizimit nuk ishin më në listën e pagave, përveç nëse kjo që nuk është më në listën e pagave ishte për shkak të diskriminimit. Ky vendim mund të ketë dëmtuar punonjësit që kanë kaluar më shumë ose gjithë jetën e tyre të punës në NSH dhe ata mund ta konsiderojnë atë si të padrejtë. Me sa duket Rregullorja e UNMIK-ut 2003/13 presupozon që një person i cili nuk është më në listën e

pagave është në pension, që merr pension të mjaftueshëm, ose që ka një punë tjetër. Në shumicën e rasteve ky supozim është i gabuar. Por, gjykata është e kufizuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 dhe nuk mund të zgjerojë numrin e të punësuarve që kanë të drejtë në pjesën e 20% nga juridiksioni i saj (të ngjashme: Aktgjykimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme SCEL-09-0001), 3 Arsyetimi në ligjor).

#### 4. Ankesat e ankuesve

R.R.(C3), B.M.(C4), M.T.(C8), D.P.(C9), R.S.(C10), P.Z.(C11), D.C.(C12), R.G.(C13), D.B.(C14), M.Z.(C15), Z.J.(C16), M.K.(C17), Z.K.(C18) janë të pranueshme dhe të bazuara.

I padituri nuk e ka kontestuar se R.R.(C3), në kohën e privatizimit, 08.03. 2006, ishte ende duke punuar në NSH dhe se ai ishte duke punuar atje që nga viti 1990, kjo do të thotë për më shumë se tre vjet. Prandaj ai duhet të pranohet në listën e punëtorëve me të drejta legjitime. E njëjta gjë vlen edhe për ankuesit

B.M.(C4), M.T.(C8), D.P.(C9), R.S.(10), P.Z.(C11), D.C.(C12), R.G.(C13), D.B.(C14), M.Z.(C15), Z.J.(C16), M.K.(C17), Z.K. (C18).

Edhe pse në kohën e privatizimit ata nuk ishin duke punuar më në NSH.

Të gjithë këta ankues ishin larguar nga NSH dhe Istogu në qershor 1999 ose pas qershorit 1999, pasi ata nuk ndiheshin më të sigurt. Asnjë prej tyre nuk kishte paraqitur dokumentet që provojnë se ai/ajo të kenë qenë të sulmuar apo diskriminuar. Asnjë prej tyre nuk kishte pohuar në mënyrë të detajuar ndonjë akt të agresionit apo diskriminimit. Por i padituri nuk e ka kontestuar se ata ishin larguar nga vendi i tyre nga frika nuk e ka kontestuar se frika e tillë në Istog pas përfundimit të luftës në ishte e arsyeshme për pjesëtarët e etnisë serbe. Në procedurën kontestimore ky mund të merret si fakt në të cilin mund të bazohet ky aktvendim dhe se nuk ka nevojë për dokument apo dëshmi tjetër.

Por edhe në qoftë se i padituri do të kundërshtojë se ankuesit u larguan nga Istogu nga frika e dhunës dhe diskriminimit gjykata do të duhet të aprovojë padinë.

Nuk është se ankuesit duhet të dëshmojnë diskriminimin, por i padituri. Barra e provës, e cila në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 bie në ankuesit, është zhvendosur në të paditurin sipas Ligjit kundër diskriminimit nr. 2004 / 3.

Neni 8 i Ligjit Kundër Diskriminimit, në barrën e provës, thotë si më poshtë:

*“8.1. Kur personat të cilët e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, paraqesin faktet para organit administrativ apo Gjykatës kompetente, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.  
8.2. Paragrafi 8.1 nuk ndalon zbatimin e rregullave të dëshmimit të cilat janë të favorshme për palën paditëse. Paditësi mund të mbrojë rastin e tij të diskriminimit edhe me metoda të tjera përfshirë edhe shfrytëzimin e dëshmive statistikore.”*

Neni 11 i Ligjit të njëjtë thotë:

*“11.1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushojnë të zbatohen të gjitha ligjet e mëparshme nga kjo fushë.*

*11.2. Dispozitat e legjislacionit që do të nxirren dhe dispozitat në fuqi lidhur me mbrojtjen e parimit të trajtimit të barabartë vlejnë dhe duhet të zbatohen edhe më tutje nëse janë më të favorshme se dispozitat e këtij ligji. “*

Fundi i luftës në mes të qytetarëve të përkatësisë etnike shqiptare dhe të qytetarëve të përkatësisë etnike serbe, dhuna dhe diskriminimi ndaj etnisë shqiptare para dhe gjatë luftës dhe tërheqja e forcave ushtarake serbe kur lufta kishte përfunduar ishin të gjitha faktet të cilat lejonin supozimin do të ndodhë diskriminimi kundër pakicës së mbetur serbe. Prandaj do të ishte barrë për të paditurin të dëshmojë se nuk kishte asnjë diskriminim, jo barrë për ankuesit se ka pasur diskriminim (neni 8.1 i ligjit kundër diskriminimit, i ngjashëm me aktgjykimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të 10 qershorit 2011 në lëndën SCEL -09-0001). Pasi që të gjithë këta ankues kanë punuar më shumë se tre vjet në NSH atyre iu ishte dashur ta braktisnin vendin e punës në vitin 1999 për arsye etnike ata duhet të konsiderohen si të punësuar, të regjistruar dhe në listën e pagave në momentin e privatizimit. Prandaj padia e tyre është e bazuar (neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13).

### **Shpenzimet gjyqësore**

Gjykata nuk e ngarkon me shpenzime apeluesin, pasi presidiumi i gjykatës deri tani nuk ka nxjerrë një listë me shkrim e cila është miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (neni.57 paragrafi 2 i Ligjit për Dhomën e Posaçme). Kjo do të thotë se deri tani nuk ka asnjë bazë të mjaftueshme ligjore për ta ngarkuar me shpenzime.

### **Këshillë Juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet apel brenda 21 ditësh te Kolegji i apelit i Dhomës së Posaçme. Apeli duhet t'i dërgohet edhe palëve tjera dhe të

dorëzohet tek trupi gjykues nga apeluesi brenda 21 ditësh. Apeluesi duhet të dorëzojë tek kolegji i apelit dëshminë se e ka dërguar ankesën edhe palëve tjera.

Afati i paraparë fillon në mesnatën e asaj dite kur apeluesit i është dërguar aktgjykimi me shkrim.

**Kolegji i apelit e refuzon apelin si të papranueshme nëse apeluesi nuk e parashtron atë brenda afatit të paraparë.**

Pala tjetër mund të ushtrojë përgjigje tek kolegji i apelit brenda 21 ditëve nga data kur i është dërguar ankesa, duke e dorëzuar përgjigjen edhe tek apeluesi dhe tek palët tjera.

Apeluesi pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja në apelin e tij, për ta dorëzuar përgjigjen e vet tek kolegji i apelit dhe për ta dërguar atë tek pala tjetër. Pala tjetër pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja e apeluesit që të dorëzojë kundërpërgjigjen e tij tek apeluesi dhe tek kolegji i apelit.

Alfred Graf von Keyserlingk, Gjyqtar Kryesues